

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

**10.08.2024
Ora, 10:02**

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve të kërkesës ankimore nr. 11”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, z. E. Mema.**

Z. E. Mema: Z. E. Mema.: Përshëndetje, sot me datë 10 gusht 2024 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit, për kërkesën ankimore nr.11, datë 9 gusht 2024, depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt “Kundështimi i vendimit nr.85, datë 5.08.2024, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Himarë”, në zgjedhjet e pjesshme të datës 4.08.2024 të KZAZ-së nr.88”. Procedura e hedhjes së shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në njërin është shënuar “Kërkesë ankimore”, e cila do të futet në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së të tërheqë goglat, në emër dhe për llogari të tyre, për caktimin e relatorit. Pasi përziejmë goglat, fillojmë me rendin alfabetin ngjitës, duke filluar nga:

Zoti Elvin Lako: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Vazhdojmë me:

Zotin Elvis Çefa: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Vazhdojmë me:

Zotin Ilirjan Rusmali: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Vazhdojmë me:

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

Zotin Koli Bele: – Kërkesa ankimore nr. 11.

Vazhdojmë me:

Zotin Ledio Braho: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Në përfundim të procedurës së shortit për kërkesën ankimore nr.11, relator është z.
Koli Bele.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



10.08.2024

Ora 13:09

RENDI I DITËS

“Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.11, kundërshtimi i vendimit nr.85, datë 5.08.2024, të KZAZ-së nr.88, duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Himarë. Subjekti ankues: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali (online), z.K. Bele (online), z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Z. E. Mema, znj. J. Dumi
- **Parti Politike:** BF (z. F. Nuri), z. V.Dule (PBDNJ)
- **Të tjerë:** S’ka

Z. K. Bele: Përshëndetje! Mirë, së pari më vjen keq për këtë lidhjen kështu, që jemi larg, që po e kryejmë në këto rrethana. Gjithsesi jemi duke bërë një seancë paraprake dhe meqenëse në këtë fazë nuk do të kemi të bëjmë me marrje provash apo me ato rrethana që përbëjnë prezencën e palëve, mund ta ezaurojmë siç e kemi bërë dhe në shumë raste të tjera. Unë, sipas shortit të hedhur nga KQZ, në lidhje me kërkesën ankimore, të depozituar me datë 9.08.2024, me objekt, me ankues Koalicionin “Bashkë Fitojmë”, është hedhur shorti dhe jam caktuar relator unë, Koli Bele. Prezentë janë katër anëtarët e tjerë të KAS-it, nga të cilët tre janë prezentë dhe vetëm i katërti është online. Z.Rusmali? Është prezent?

Z. I. Rusmali: Po. Unë ju dëgjoj.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

Z. K. Bele: Prezente gjithashtu është administrata e KQZ-së, e përfaqësuar nga?

Z. E. Mema: E përfaqësuar nga Erdal Mema dhe Juneta Dumi.

Z. K. Bele: Po, faleminderit! Kemi prezencë të palëve ankuese apo palët të tjera?

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Po, është prezent Franci Nuri, përfaqësues i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Gjithashtu është prezent dhe z.Dule.

Z. V. Dule, Kryetar i PBDNJ: Prezent!

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Përfaqësues, po themi, i cili ka depozituar kërkesën për të qenë palë e interesuar në këtë proces.

Z. K. Bele: Dakord. Faleminderit! Kërkesa e përcjellë është...

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Si parti, pjesë e koalicionit, po.

Z. K. Bele: ...standard i pranuar. Megjithatë me mirëkuptimin e kolegëve, për ta bërë seancën më të prekshme dhe më të kuptueshme, nëse s’ka ndonjë kundërshtim, do ia kaloja relatimin z.Çefa. Z.Çefa mund ta vazhdoni ju?

Z. E. Çefa: Patjetër koleg! Në këtë fazë e vazhdoj unë.

Z. K. Bele: Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

Z. E. Çefa: Ju ndërkohë do të qëndroni online të na ndiqni, për votimin më pas.

Z. K. Bele: Patjetër.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Atëherë e vijojmë seancën. Fillimisht, kolegët janë dakord me kërkesën e ndërmjetme të paraqitur nga z. Vangjel Dule për të qenë palë në këtë procedim?

Z. E. Lako: Z. Dule e kërkon si përfaqësues i koalicionit, i subjektit të vet apo si individ?

Z. V. Dule, Kryetar i PBDNJ: Si parti, përbërëse e koalicionit.

Z. E. Çefa: Dakord. Pra, si Kryetar i “Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”. Atëherë kolegë, dakord!

Z. K. Bele: Dakord.

Z. E. Çefa: Atëherë miratohet! “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” është palë e interesuar në këtë procedim dhe nga ky moment do të jetë prezent në këtë seancë dhe më pas edhe në seancën e shqyrtimit të themelit. Atëherë për sa i përket elementëve të formës dhe të përmbajtjes, që mos të humbim shumë kohë, z.Nuri e keni fjalën ju. Si mendoni t’i propozoni KAS-it kalimin në shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Po, faleminderit. Ne e kemi paraqitur në kërkesë, kemi paraqitur të gjithë argumentat që mendojmë se na legjitimojnë për këtë kërkesë ankimore. Pa u zgjatur, kërkojmë si dhe në rastet e tjera që çështja të kalojë në seancë për shqyrtim të thelluar. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Po, ju faleminderit! Atëherë përfaqësuesi i KQZ-së, shkurtimisht ju lutem, mendoni që i plotëson elementët formalë, të parashikuar në Kod kjo kërkesë ankimore dhe më pas të kalohet për shqyrtim?

Z. E. Mema: Nga verifikimi paraprak konstatohet se kërkesa ankimore është brenda afatit të përcaktuar në ligj, si dhe i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, të parashikuara në nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Për këto arsye i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Z.Dule në këtë fazë të këtij procedimi administrativ keni diçka për të thënë? Vetëm për elementët e formës dhe të përmbajtjes, pra kjo nuk është seancë e themelit, kjo është thjesht seancë paraprake.

Z. V. Dule, Kryetar i PBDNJ: Jo.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! Atëherë, përpara se ne të tërhiqemi për të diskutuar më pas, ju keni kërkuar, në mos gabohem marrjen e disa provave, administrimin e disa provave nga KQZ apo jo?

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Po, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

Z. E. Çefa: Po a mund të na i citoni shkurtimisht z.Nuri?

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Shkurtimisht, po. Janë disa problematika, në fakt, në lidhje me zgjedhjet e Himarës. Ne kemi kërkuar të paktën pesë elementë. E para ka të bëjë me 6000 zgjedhësit, mbi 6000 zgjedhës, kartat e ID-së të të cilëve rezultojnë se kanë skaduar, nuk kanë qenë të vlefshme, po themi. Këtu ne kërkojmë mbi bazën e dispozitave të Kodit Zgjedhor që anëtarët e KAS-it të marrin provat në lidhje me këtë indicie, që konsiston në raportin e audituesit teknikien, raportin dhe analizën e të gjitha pajisjeve PEI dhe çdo komunikim fizik apo elektronik, email që KQZ-ja mund të disponojë lidhur me problematikën e zgjedhjeve të Himarës. Pra, për kartat ID, numrin e kartave ID të skaduara, pasaportat e skaduara, etj., që kanë penguar të drejtën e votës. Kjo është e para. E dyta, ne kemi indicie nga informacionet tona, se në regjistrin e posaçëm, në regjistrat e posaçëm të zgjedhësve, janë evidentuar rreth 560 zgjedhës në Bashkinë e Himarës, të cilët nuk janë lejuar të votojnë, iu është ndërprerë procesi i votimit, më saktë, për shkak se karta e tyre ID kishte skaduar. Emrat e këtyre personave dhe arsyet pse është ndërprerë procesi i votimit për këta persona, ne na është thënë se janë të regjistruar në regjistrin e posaçëm të zgjedhësve në çdo qendër votimi. Kështu që kërkojmë për rrjedhojë nga KAS, që të merret si provë duke proceduar me administrimin e të gjithë regjistrave të posaçëm të 36 qendrave të votimit në Bashkinë Himarë. E treta, kemi indicie nga anëtarët tanë në KZAZ dhe përfaqësuesit tanë apo vëzhguesit, se janë rreth 260 zgjedhës që janë lejuar të votojnë me karta identiteti të rinovuara një apo ditë para zgjedhjeve, që në fakt pajisja PEI nuk ishte përditësuar, ose nuk e di. Pajisja PEI nuk i ka, po themi njohur, i ka refuzuar si zgjedhës dhe votimi për këta 260 persona është kryer pasi është mbajtur shënim manualisht, të dhënat e këtyre personave. Ne gjykojmë se kjo është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe duke qenë se kemi

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 10.08.2024

dyslime të arsyeshme se këta persona që kanë arritur të rinovojnë kartat në një kohë rekord dhe për aq sa pajisja PEI nuk ishte përditësuar që t'i njihete, ne dyshojmë se këta kanë qenë votues të kontrolluar, të patronazhuar nga segmente pranë mazhorancës. Për këtë arsye kërkojmë marrjen dhe administrimin e provës nga KAS-i që do të thotë, të gjithë procesverbalet dhe të gjithë regjistrat e posaçëm të çdonjërës prej 36 qendrave të votimit në Himarë ku janë pasqyruar manualisht të dhënat e votuesve me këtë problematikë. E katërta, kërkojmë informacion. Informacioni që ne kemi është se janë 70-80 punonjës të administratës publike, administratës shtetërore ose vendore që ishin angazhuar si anëtarë të qendrave të votimit në favor të kandidatit të PS, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor sepse kemi dyshime të arsyeshme se këta persona kanë qenë të pa pajisur me autorizim paraprak nga DAP-i. Ne kërkojmë nga KAS-i marrjen e provës, që konsiston në çdo lloj dokumentacioni që mund të ketë KQZ-ja, KZAZ-ja apo edhe vetë DAP-i, lidhur me emrat, pozicionin në administratën publike të anëtarëve në 36 qendrat e votimit dhe nëse këta të fundit kishin apo jo, paraqitur, brenda afatit ligjor autorizimin e duhur nga ana e Departamentit të Administratës Publike, të DAP-it. E fundit, kemi indicie që kemi grumbulluar dhe nga të dhënat që na kanë ardhur, që janë të paktën 360 zgjedhës, të cilët janë shtuar në Himarë nga maji i vitit 2023. Kemi dyshime që një pjesë e mirë e këtyre individëve nuk janë banorë të përhershëm të Himarës, janë regjistruar në mënyrë fiktive, pjesa më e madhe e tyre duke mos pasur as pagesa uji, drita, etj., me radhë. Disa, na është thënë që janë të regjistruar dhe në godina karabina, të papërshtatshme për banesa, është bërë dhe kallëzim përkatës. Çfarë kërkojmë nga KAS-i? Kërkojmë marrjen e provës duke administruar të dhënat e Drejtorisë së Gjendjes Civile, raportin e audituesit teknikien lidhur me problematikën e shtimit të 360 zgjedhësve, ku mbi 90 persona rezultojnë të shtuar në listat e zgjedhësve vetëm mbas ditës kur Presidenti i Republikës dekretoi datën e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

zgjedhjeve. Ndërkohë që siç dihet, në krahasim me tre vitet e fundit nga Himara kishin lëvizur më pak se 20 zgjedhës, 90 e më tepër janë shtuar vetëm muajin e fundit, nga 360 në total. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Po ju faleminderit! Nga kolegët? Po, z.Lako!

Z. E. Lako: Z.Nuri, ju siç e dini, sepse keni eksperiencë tani në mbledhjet e KAS-it, ne nuk po e shqyrtojmë në themel, se këto janë pretendime që i takojnë ditës kur çështja të shqyrtohet në themel. Këshilla ime është që ju, edhe KAS-i mund t'ju japi kohën e nevojshme, që këto pretendime, që ju i mbështesni, të provonit që provat, patjetër që ju e keni barrën e provës, që t'i mblidhni dhe t'i dorëzoni pranë KAS-it sepse ju e ngrini pretendimin dhe kjo është praktika që ka ngritur KAS-i. Për ato prova të cilat mundet që dy anëtarë të KAS-it të kërkojnë në qoftë se ju e keni të pamundur t'i gjeni, ajo është pastaj një çështje që do i përkasë seancës në themel. Ne si praktikë, si KAS, gjithmonë kemi ndjekur që, ai që bën ankimin, ajo palë ka detyrën për të sjellë provat pranë KAS-it. Pra, nuk merr KAS-i prova për palën se nuk jemi palë në proces. Ne jemi ata që do marrin vendimin mbi bazën e provave të paraqitura. Nëse dy anëtarë të KAS-it, në seancën e themelit apo gjatë kësaj kohe, do t'u lindi dëshira apo vullneti për të kërkuar prova të cilat ju nuk mund t'i dispononi dhe mund t'i disponojnë dy anëtarë, kjo është një çështje që i përket vullnetit të KAS-it. Ndërsa ju nëse do të kërkonit kohë për të mbledhur këto prova ju e dini që ju e keni detyrën për t'i depozituar pranë KAS-it. Nuk është se KAS-i nuk do që të marrë prova për ju pak a shumë. Këtu ishte pak a shumë ndërhyrja që bëri zoti Çefa në mos gabofsha.

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Po, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*


Z. E. Çefa: Pra, qëllimi im, që e bëra këtë pyetje në këtë fazë ishte pikërisht kjo, që domethanë, që desha të di nëse ju e keni ezauruar rrugën vetë për t'i kërkuar ju zyrtarisht këto prova dhe eventualisht nëse ju është refuzuar vënia në dispozicion nga institucionet? Në atë rast pastaj kemi mekanizmin tjetër ligjor për... Mekanizmi i parë është që ju i kërkonit dhe si rregull duhet t'jua vënë në dispozicion sepse këtu s'ka çështje sekreti apo çështje ndjeshmërie. Kështu që absolutisht keni legjitimitetin për t'i kërkuar dhe në këtë fazë. Në qoftë se kjo do të marrë pak kohë, ne kemi gjithë mundësinë që seancën tjetër, nëse do të vendosim ta kalojmë, ta lëmë me një afat të arsyeshëm, pra ky ishte dhe qëllimi pse e bëra pyetjen.

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Dakord, e kuptova. Zyrtarisht ne nuk i kemi kërkuar këto prova ende në KQZ, do t'i kërkojmë por menduam që të shfrytëzonim mundësinë edhe me... Mundësinë që lejonte Kodi Zgjedhor me votën e dy anëtarëve të KAS-it për t'i marrë këto prova dhe për të fituar kohë, por meqenëse mund të kemi më tepër kohë në dispozicion, atëherë do të procedojmë me kërkesë zyrtare në KQZ dhe eventualisht në funksion në kësaj.

Z. E. Çefa: Po ju faleminderit! Kolegu Braho!

Z. L. Braho: Tani një nga provat që cituat ju, ishte lista e anëtarëve të qendrave të votimit, pra çdo KQV ka pasur, tani ju i keni këto sepse keni qenë në KZAZ. Është KZAZ-ja që i miraton të gjithë përbërjet e KQV-ve. Pastaj informacioni nga DAP-i ju duhet ta tentoni njëherë, t'i kërkonit DAP-it informacion duke pasur emrat dhe në qoftë se kjo dështon, pastaj do jetë me vendimmarrje tonën, në qoftë se do i drejtohem i ne DAP-it për ta marrë këtë informacion apo jo, pra, një pjesë e provave. Ajo që kisha të paqartë ishte pjesa e atyre 6000 personave që ju thoni se kanë pasur

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

karta identiteti të skaduara. Kjo del nga auditimi që është bërë? Pra, nga ka dalë kjo shifër? Nga keni ju informacion të kësaj shifre?

Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF: Atëherë ky informacion përveçse është botuar dhe në media zyrtare, ne e kemi indicie që ekziston dhe në raportet dhe në komunikimet që mund të jenë në lidhje me pajisjen PEI apo dhe në raportin e audituesit, prandaj dhe ne kërkojmë çdo lloj komunikimi që mund të ketë KQZ-ja në lidhje me çështjen dhe problematikën e PEI-it, qoftë shkresor, qoftë elektronik, email.

Z. E. Çefa: Po, ju faleminderit! Kolegët, z.Rusmali dhe z.Belev, ndonjë pyetje? Meqenëse jeni, duhet t'ju kisha pyetur juve të parët, në fakt, po ju kërkoj ndjesë!

Z. K. Belev: S'ka problem, në këtë fazë...

Z. I. Rusmali: Në qoftë se mund të flas unë...

Z. K. Belev: ...proceduariale dhe në vlerësimin tim...

Z. I. Rusmali: ...sepse lënda e sotme e seancës paraprake...

Z. E. Çefa: Një sekond ju lutem se për shkak të teknikës, po flisni njëkohësisht. Z. Belev po ia jap fjalën z. Rusmali, meqenëse është edhe më i madh në moshë.

Z. K. Belev: Dakord.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

Z. E. Çefa: Z. Rusmali, flisni ju!


Z. I. Rusmali: Faleminderit! Lënda sot është e përcaktuar, ne kemi diskutimin në seancë paraprake të ligjitimitit të palës dhe të kompetencës së KAS-it. Ky diskutim duket se është i mbyllur, të gjithë janë dakord që kompetenca është aty, legjitimimi është aty dhe afati është aty. Unë nuk kam, besoj nuk kam çfarë të them lidhur me kërkesën për marrje provash, kolegët e thanë shumë qartë për subjektin. Subjekti duhet të identifikojë qartë pretendimet e veta dhe duhet të lidhë me pretendimet e veta provat që disponon. Ka të gjithë kohën e nevojshme në dispozicion që t'i kërkojë provat atje ku provat janë, jo të kërkojë që punën e tij ta bëjë KAS-i. Kështu që në këtë pikë, përfaqësuesi i subjektit tha që do ta marrë seriozisht këtë gjë, le të shpresojmë që ta bëjë seriozisht dhe kur të caktohet seanca të jemi të gjithë të përgatitur, për ta shqyrtuar në themel çështjen. Kaq kisha.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit z. Rusmali! Z. Bele atëherë po ju rijap fjalën dhe njëherë.

Z. K. Bele: Jo, në këtë fazë që jemi, shpjegimet proceduriale u bënë nga ana juaj, si dhe u ezauruan pyetjet, kështu që nuk kam gjë për të shtuar, mos të bëjmë përsëritje.

Z. E. Çefa: Dakord, ju faleminderit! Atëherë ne po e ndërpresim seancën këtu, pesë minuta dhe do t'ju rithërrasim që të shpallim vendimin për këtë fazë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.08.2024*

Rifillon seanca

Ora 13:26

Z. K. Bele: Atëherë në përfundim të shqyrtimit bazë, paraparak, vendosim si datë për çështje për shqyrtim themeli, duke caktuar si datë, datën 21 gusht, ora 12.00. Të merren masa për njoftimet përkatëse nga administrata. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 16

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

